

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.143 /2018	Data: 31.12.2018	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 11, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 35/2012), nenit 21 të Rregullores Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/ 2010, në mbledhjen e mbajtur më 31.12.2018 mori këtë:

V E N D I M

PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ME PRONËN E PALUAJTSHME TË PERSONIT FIZIK

1. Miratohet këmbimi i pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Agim(Rrustem)Qapkunaj-person fizik, me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm publik përkatësisht hapjen dhe asfaltimin e rrugës të " Dheu i Bardhë " në Istog.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, Njësia Kadastrale P-70806020-00178-6 (Zona Kadastrale-Istog) me sipërfaqe prej 3464 m² prej së cilës janë marrë 485 m², në vendin e quajtur "Rudesh" në pjesën e pronës 1/1 dhe Njësia Kadastrale P-70806020-00180-4 (Zona Kadastrale-Istog) me sipërfaqe prej 1626 m², prej së cilës janë marrë 205 m², në vendin e quajtur "Rudesh", në pjesën e pronës 1/1, gjithsej për të dy parcelat kadastrale me sipërfaqen e përgjithshme prej 690 m², në pronësi të Agim(Rrustem)Qapkunaj-person fizik, me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm, përkatësisht hapjen dhe asfaltimin e rrugës të " Dheu i Bardhë " në Istog do të këmben me pjesë ideale nga Njësia Kadastrale P-70806020-00191-0, në Zonën Kadastrale-Istog (P.SH.SH e Kuvendit Komunal), me sipërfaqe të përgjithshme prej 3007 m², pjesa e pronës 1/1, në vendin e quajtur "Istog i Vogël".
3. Vlerësimin e pronës sipas këtij Vendimi që është objekt i këmbimit do ta bëjë zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme e cila është në kuadër të departamentit të tatimit në pronë pranë Ministrisë së Financave.
4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, për realizimin e tij kujdesen, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Istogut.

Më kopje të këtij vendimi të njoftohen: Kryetari i Komunës, MAPL, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit të Komunës.